




Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac – Municipality of Rahovec

KRYETARI I KOMUNËS
Presednik Opštine – Municipal Mayor

**LISTA E VENDIMEVE TË MARRA NGA KRYETARI I KOMUNËS SË RAHOVECIT,
Z. SMAJL LATIFI**

MAJ 2024

NR.	EMRI I VENDIMIT	NR. I PROTOKOLLIT
1.	Vendim për caktimin e komisionit për vlerësimin e ofertave	NRP-02-4175-2024
2.	Vendim për caktimin e komisionit për vlerësimin e ofertave	NRP-02-4177-2024
3.	Vendim	NRP-02-4180-2024
4.	Vendim për qasje në dokumente publike	NRP-02-4182-2024
5.	Vendim për caktimin e grupit punues për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për Taksa Komunale	NRP-02-4184-2024
6.	Vendim për caktimin e komisionit për vlerësimin e ofertave	NRP-02-4189-2024
7.	Vendim	NRP-02-4192-2024
8.	Vendim	NRP-02-4194-2024
9.	Vendim	NRP-02-4195-2024
10.	Vendim për ndërrimin e pozicioneve në kontratën "Ndërtimi i parqeve në Komunën e Rahovecit"	NRP-02-4196-2024
11.	Vendim për ndërrimin e pozicioneve "Ndërtimi i parqeve në Opterushë, Retijë e Poshtme, Dejnë dhe kolektorit të ujërave të zeza në Ratkoc dhe Rahovec"	NRP-02-4197-2024
12.	Vendim për qasje në dokumente publike	NRP-02-4198-2024
13.	Vendim	NRP-02-4201-2024
14.	Vendim për caktimin e komisionit për vlerësimin e ofertave	NRP-02-4202-2024
15.	Vendim për caktimin e komisionit për vlerësimin e ofertave	NRP-02-4203-2024
16.	Vendim	NRP-02-4205-2024
17.	Vendim	NRP-02-4210-2024
18.	Vendim për ndërprerje të kontratës me marrëveshje të dyanshme, me titull "Shërbime konsulente individuale për nevojat e Komunës së Rahovecit"	NRP-02-4211-2024
19.	Vendim	NRP-02-4212-2024
20.	Vendim për caktimin e menaxherit të kontratës dhe të mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës	NRP-02-4213-2024
21.	Vendim për pranimin në marrëdhënie pune	NRP-02-4215-2024

22.	Vendim	NRP-02-4218-2024
23.	Vendim	NRP-02-4221-2024
24.	Vendim për caktimin e menaxherit të kontratës dhe të mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës	NRP-02-4227-2024
25.	Vendim për caktimin e komisionit për vlerësimin e ofertave	NRP-02-4231-2024
26.	Vendim për caktimin e komisionit për vlerësimin e ofertave	NRP-02-4232-2024
27.	Vendim për caktimin e këshillit organizues për nder të 14 Qershorit - Ditës së Çlirimit të Komunës	NRP-02-4234-2024
28.	Vendim	NRP-02-4237-2024
29.	Vendim për ndërrimin e pozicioneve në kontratën me titull "Ndërtimi i rrugëve lokale në Komunën e Rahovecit - faza e dytë"	NRP-02-4238-2024
30.	Vendim për qasje në dokumente publike	NRP-02-4242-2024
31.	Vendim për caktimin e menaxherit të kontratës dhe të mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës	NRP-02-4243-2024
32.	Vendim për caktimin e menaxherit të kontratës dhe të mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës	NRP-02-4245-2024
33.	Vendim	NRP-02-4246-2024
34.	Vendim për formimin e komisionit për shqyrtimin dhe vlerësimin e aplikacioneve	NRP-02-4248-2024
35.	Vendim për caktimin e komisionit për vlerësimin e ofertave	NRP-02-4255-2024
36.	Vendim për caktimin e menaxherit të kontratës dhe të mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës	NRP-02-4264-2024
37.	Vendim për caktimin e menaxherit të kontratës dhe të mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës	NRP-02-4265-2024
38.	Vendim për caktimin e menaxherit të kontratës dhe të mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës	NRP-02-4266-2024
39.	Vendim për caktimin e menaxherit të kontratës dhe të mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës	NRP-02-4267-2024
40.	Vendim për caktimin e menaxherit të kontratës dhe të mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës	NRP-02-4268-2024
41.	Vendim për caktimin e menaxherit të kontratës dhe të mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës	NRP-02-4269-2024
42.	Vendim për caktimin e menaxherit të kontratës dhe të mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës	NRP-02-4270-2024



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac/Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA RAHOVEC / OPŠTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY RAHOVEC

KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS / KABINET PREDSEDIKA OPŠTINE / MUNICIPAL MAYOR CABINET

Njësia Nr./Br./No 02 (Kabineti i Kryetarit të Komunës)

Nr./Br./No 4175 Nr. i faq./Br.str./No.pg 121

Data/Datum/Date 02 / 5 / 24

RAHOVEC / ORAHOVAC

Në bazë të nenit 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040, nenit 59 të Ligjit Nr.04/L-042 të Prokurimit Publik, nenit 37 të Ligjit Nr.05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Prokurimin Publik, nenit 69 dhe 92 të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr.1005, të datës 29.3.2017, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

Për caktimin e komisionit për vlerësimin e ofertave

1. **Caktohet** komisioni për vlerësimin e ofertave për projektin: “Furnizim me shumësia për shkolla të Komunës së Rahovecit”, me Nr. prokurimi: 623-24-3881-1-3-6 dhe Nr. të brendshëm: 623-24-040-1-3-6, të datës 30.4.2024, në këtë përbërje:
 - 1.1. Jeton Krasniqi, kryesues,
 - 1.2. Enise Dina, anëtare,
 - 1.3. Antigona Krasniqi, anëtare.
2. Komisioni ka për detyrë të bëjë vlerësimin e ofertave për projektin “Furnizim me shumësia për shkolla të Komunës së Rahovecit”, me Nr. prokurimi: 623-24-3881-1-3-6 dhe Nr. të brendshëm: 623-24-040-1-3-6, të datës: 30.4.2024.
3. Obligohet komisioni që këto punë t’i kryejë duke u bazuar në legjislacionin në fuqi.
4. Komisioni do të fillojë punën menjëherë pas nënshkrimit të këtij vendimi dhe punët duhet të përfundojnë në afat jo më shumë se 30 ditë nga hapja e ofertave.
5. Vendimi hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

Vendimi u dërgohet:

- Anëtarëve të komisionit,
- Zyrës së Prokurimit, dhe
- Arkivit.






Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit



Opština Orahovac/Municipality Rahovec

Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



Në bazë të nenit 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040, nenit 59 të Ligjit Nr.04/L-042 të Prokurimit Publik, nenit 37 të Ligjit Nr.05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Prokurimin Publik, nenit 69 dhe 92 të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr.1005, të datës 29.3.2017, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

Për caktimin e komisionit për vlerësimin e ofertave

- 1. Caktohet** komisioni për vlerësimin e ofertave për projektin: “Shërbime për të gjitha manifestimet e aktiviteteve kulturore për vitin 2024, shërbime me led profesional, zërimin dhe ndriçimit profesional për nevojat e komunës”, me Nr. prokurimi: 623-24-3946-2-3-6 dhe Nr. të brendshëm: 623-24-039-2-3-6, të datës 30.4.2024, në këtë përbërje:
 - 1.1.** Faik Thaqi, kryesues,
 - 1.2.** Enise Dina, anëtare,
 - 1.3.** Vjollca Berisha, anëtar.
- Komisioni ka për detyrë të bëjë vlerësimin e ofertave për projektin “Shërbime për të gjitha manifestimet e aktiviteteve kulturore për vitin 2024, shërbime me led profesional, zërimin dhe ndriçimit profesional për nevojat e komunës”, me Nr. prokurimi: 623-24-3946-2-3-6 dhe Nr. të brendshëm: 623-24-039-2-3-6, të datës 30.4.2024.
- Obligohet komisioni që këto punë t’i kryejë duke u bazuar në legjislacionin në fuqi.
- Komisioni do të fillojë punën menjëherë pas nënshkrimit të këtij vendimi dhe punët duhet të përfundojnë në afat jo më shumë se 30 ditë nga hapja e ofertave.
- Vendimi hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

Vendimi u dërgohet:

- Anëtarëve të komisionit,
- Zyrës së Prokurimit, dhe
- Arkivit.






Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac/Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



Komisioni Komunal për Riintegrim, bazuar në nenin 13 të ligjit për vetëqeverisje lokale dhe neni 21, paragrafi 1, 3 dhe 4, neni 33, paragrafi 1, nën paragrafi 1.5 dhe 1.10 dhe neni 44, nën paragrafi 4.1 dhe paragrafi 5 të Rregullores të QRK nr. 22/2020 për Riintegrimin e Personave të Riatdhesuar, mbështetur në Vendimin e Kryetarit të Komunës së Rahovecit Nr. 271 të datës 14.07.2014 për themelimin e Komisionit Komunal për Riintegrim, në harmoni me Ligjin Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, nxjerr:



V E N D I M

1. [REDACTED] e kthyer me dt. 12.12.2019 me dhunë, për mbështetje nga Masat Emergjente të Riintegritimit për vazhdim akomodimi edhe për 6 muaj, nga data 01.05.2024 deri me 31.10.2024, në vlerë 280 Euro per çdo muaj, duke i përfshirë edhe shpenzimet komunale, sipas kërkesës me nr. 1422 datë 22.04.2024 të parashtruar në ZKKK në Komunën e Rahovecit dhe sipas ofertës më të lirë.
2. Përfitues nga pika 1 e këtij vendimi është familja tre (3) anëtarëshe nga komuna e Rahovecit
3. Për zbatimin e këtij Vendimi obligohet Ministria e Punëve të Brendshme.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

A r s y e t i m

Komisioni Komunal për Riintegrim, në seancën e mbajtur më datë 29.04.2024, ka shqyrtuar kërkesën e parashtruar me datë 22.04.2024 nga [REDACTED] në Komunën e Rahovecit për mbështetje nga Masat Emergjente të Riintegritimit, për akomodim me qira, duke u bazuar në rekomandimet e Zyrës Komunale për Kumunitete dhe Kthim.

Përfituesja momentalisht po qëndron në gjendje të rëndë socio-ekonomike, të cilën i ka skaduar kontrata e qirasë, dhe është rast i cënuar, nënë vetëushqyese me dy fëmijë, njëri i mitur ndersa tjetri, me sëmundje dhe vështërsi tjera shëndetsore shoqëruese, shtuar këtu edhe rrezikun potencial për tu kthyer në komunën e Rahovecit (vendin e origjines) nga ish-bashkshorti i saj, si viktime e dhunës në familje, rast i njohur edhe nga organet kompetente të sigurisë.

Sipas rregullorës së paraparë, kërkesa për akomodim me qira i aprovohet për periudhën 6 mujore nga 01.04.2024 deri me 31.10.2024, në vlerë 280 € në muaj, për të vazhduar procesi i trajtimit të statusit të saj më tutje për mbështetje nga niveli komunal, pasi që e njejta zyrtarisht do të transferohet banore e komunës së Prishtinës.

Komisioni ka shqyrtuar të gjitha dokumentet e prezentuara, dhe sipas dëshmive të paraqitura, konstaton se e riatdhesuara i **plotëson kriteret** për mbështetje nga Masat Emergjente të Riintegritimit, për akomodim me qira të përcaktuar me Rregulloren QRK nr. 22/2020 për Riintegrimin e personave të Riatdhesuar, neni 44, nën paragrafi 4.1 dhe paragrafi 5, neni 21, paragrafi 1, 3 dhe 4, dhe neni 33, paragrafi 1, nenparagrafi 1.10, paragrafi 2 dhe 6, andaj u vendos si në dispozitivin

Këshillë juridike :

Kundër këtij vendimi, pala e pakënaqur në afat prej 30 (tridhjet) ditësh pas pranimit të tij, mund të paraqes ankesë në Komisionin e Ankesave.

Rahovec, 29.04.2024

Kopja e vendimit i dërgohet:

1. [REDACTED]
2. Koordinatorit Rajonal të MPB,
3. Zyrës Komunale për Kthim dhe Komunitete,
4. Arkivit të Komunës.





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit



Opština Orahovac/Municipality of Rahovec

Kryetari i Komunës – Presednik Opštine

Municipal Mayor

KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS / KABINETI I PRESIDENTIT TË OPŠTINËS / MUNICIPAL MAYOR CABINET

Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)

Nr./Br./No 4182 Nr. i faq./Br.str./No.pg 122

Data/Datum/Date 02/ 5/ 24

RAHOVEC / ORAHOVAC

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Republikës së Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 21 dhe 26 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, nenit 11 paragrafi 2 të Ligjit Nr. 06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike, nenit 74 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 i datës 29.03.2017, Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M

Për qasje në dokumente publike

1. **Miratohet** e bazuar kërkesa me Nr. Prot. 02/ 4151 /24, e datës 25.4.2024 për qasje në dokumente publike nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF) dhe i ofrohet qasje e **plotë** në dokumente publike, dhe atë: Mbështetja financiare publike për organizatat joqeveritare.
2. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

A r s y e t i m

Në mbështetje të nenit 10 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike (QDP), Komuna e Rahovecit ka pranuar kërkesën me Nr. Prot. 02/ 4151 /24, e datës 25.4.2024 për qasje në dokumente publike nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF), për qasje në dokumente publike.

Pas shqyrtimit të kërkesës, të njëjtit i ofrohet qasje e **plotë** në dokumente publike dhe atë: Mbështetja financiare publike për organizatat joqeveritare.

Kërkesa për Qasje në Dokumente Publike është pranuar në mënyrë elektronike.

Komuna e Rahovecit, pas shqyrtimit të kërkesës, si dhe pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkrësive të lëndës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi, pala e pakënaqur mund të paraqes ankesë në Agjencionin për Informim dhe Privatësi brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga data e pranimit të tij.

Vendimi u dërgohet:

- Znj. Blerta Gashi, Zyrtare për shqyrtimin fillestar të QDP,
- Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF), dhe
- Arkivët.





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac/Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS/KABINETI PREDSIEDNIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET

Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)

Nr./Br./No 4184 Nr. i faq/Br.str/No.pg 122

Data/Datum/Date 08/5/24

RAHOVEC / ORAHOVAC

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 74 dhe nenit 92, paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr. 1005, të datës 29.3.2017, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

Për caktimin e Grupit Punues për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për Taksa Komunale

1. **Caktohet** Grupi Punues për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për Taksa Komunale në Komunën e Rahovecit, në këtë përbërje:
 - 1.1. Fatmir Iska – nënkryetar i Komunës, kryesues,
 - 1.2. Erhan Morina – drejtor i Drejtorisë për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm, anëtar,
 - 1.3. Afrim Limani – drejtor i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, anëtar,
 - 1.4. Albnor Mullabazi – drejtor i Drejtorisë për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit, anëtar,
 - 1.5. Përparim Krasniqi – drejtor i Drejtorisë për Shërbime Publike, anëtar,
 - 1.6. Saranda Sallteku – drejtore e Drejtorisë për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale, anëtare,
 - 1.7. Avni Morina – drejtor i Drejtorisë për Arsim, anëtar,
 - 1.8. Afrim Oruqi – drejtor i Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë, anëtar,
 - 1.9. Besnik Hoti – drejtor i Drejtorisë për Administratë, anëtar,
 - 1.10. Berat Duraku – drejtor i Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, anëtar,
 - 1.11. Nora Boshnjaku – drejtore e Drejtorisë për Inspektim, anëtare,
 - 1.12. Afrim Dina - drejtor i Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport, anëtar,
 - 1.13. Besmire Bytyqi – drejtore e Drejtorisë për Mbrojtje dhe Shpëtim, anëtare,
 - 1.14. Isak Hoti – udhëheqës i Zyrës Ligjore, anëtar,
 - 1.15. Mirsad Shala – zyrtar Ligjor, anëtar.
2. Grupi Punues ka për detyrë që të bëjë ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për Taksa Komunale në Komunën e Rahovecit.
3. Obligohet Grupi Punues që, pas përfundimit të punëve, të hartojë raport me shkrim për kryetarin e Komunës.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

Vendimi u dërgohet:

- Anëtarëve të Grupit Punues, dhe
- Arkivit.





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit



Opština Orahovac/Municipality Rahovec

Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor

REPUBLICA E KOSOVES / REPUBLIKA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA RAHOVEC / OPŠTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS / KABINET PRESEDIKA OPŠTINE / MUNICIPAL MAYOR CABINET

Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 4189 Nr. i faq/Br.str/No.pg 122
Data/Datum/Date 08/ 5 /24
RAHOVEC / ORAHOVAC

Në bazë të nenit 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040, nenit 59 të Ligjit Nr.04/L-042 të Prokurimit Publik, nenit 37 të Ligjit Nr.05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Prokurimin Publik, nenit 69 dhe 92 të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr.1005, të datës 29.3.2017, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

Për caktimin e komisionit për vlerësimin e ofertave

1. **Caktohet** komisioni për vlerësimin e ofertave për projektin: “Vendosja e ashensorit në objektin e ri të komunës - ritenderim”, me Nr. prokurimi: 623-24-3623-5-2-1 dhe Nr. të brendshëm: 623-24-015-5-2-1, të datës 7.5.2024, në këtë përbërje:
 - 1.1. Jetmir Ukaj, kryesues,
 - 1.2. Enise Dina, anëtare,
 - 1.3. Vjollca Berisha, anëtare.
2. Komisioni ka për detyrë të bëjë vlerësimin e ofertave për projektin “Vendosja e ashensorit në objektin e ri të komunës - ritenderim”, me Nr. prokurimi: 623-24-3623-5-2-1 dhe Nr. të brendshëm: 623-24-015-5-2-1, të datës 7.5.2024.
3. Obligohet komisioni që këto punë t’i kryejë duke u bazuar në legjislacionin në fuqi.
4. Komisioni do të fillojë punën menjëherë pas nënshkrimit të këtij vendimi dhe punët duhet të përfundojnë në afat jo më shumë se 30 ditë nga hapja e ofertave.
5. Vendimi hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

Vendimi u dërgohet:

- Anëtarëve të komisionit,
- Zyrës së Prokurimit, dhe
- Arkivit.

Smajl Latifi
Kryetar i Komunës



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo

Komuna Rahovec
Opština Orahovac / Municipality Rahovec



Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Mayor Office

REPUBLICA E KOSOVES / REPUBLIKA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA RAHOVEC / OPŠTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY RAHOVEC

KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS / KABINET PREDSEDIKA OPŠTINE / MUNICIPAL MAYOR CABINET

Njësia Nr./Br./No 02 (Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 4192, Nr. i faq./Br.str./No.pg 123
Data/Datum/Date 08 / 5 / 24
RAHOVEC / ORAHOVAC

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës Nr. 03/L040, (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, 28/2008), nenit 74 dhe nenit 92, paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës, Nr.1005, i datës 29.3.2017, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

Formohet komisioni për përkrahjen e fermerëve me preparate për luftimin e insektit “Cikadia”, të hardhisë së rrushit

1. Caktohet komisioni në këtë përbërje:
 - 1.1. Ilvi Durguti, kryesues
 - 1.2. Kosovare Gashi, anëtare,
 - 1.3. Bahrije Çmega, anëtare.
2. Komisioni ka për detyrë që të bëjë përzgjedhjen e fermerëve të cilët do t'i përkrahë me preparate për luftimin e insektit “CIKADIA”, të hardhisë së rrushit.
3. Obligohet komisioni që, pas përfundimit të punëve, të hartojë raport me shkrim për kryetarin e Komunës dhe Drejtorinë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural.
4. Komisioni do të fillojë punën menjëherë dhe punët duhet të përfundojnë në një afat të arsyeshëm.
5. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen anëtarët e komisionit dhe Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural.
6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit nga kryetari i Komunës.

U dërgohet:

- Anëtarëve të komisionit,
- Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, dhe
- Arkivit.





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit



Opština Orahovac / Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine / Municipal Mayor

REPUBLICA E KOSOVES / REPUBLIKA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVO
OPŠTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS / KABINET PREDSIEDNIKA OPŠTINE / MUNICIPAL MAYOR CABINET

Njësia Nr./Br./No 02 (Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 4194 Nr. i faq./Br.str./No.pg 123
Data/Datum/Date 10 / 5 / 24
RAHOVEC / ORAHOVAC

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040 (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008), nenit 74 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 i datës 29.03.2017, nenit 2, pika 1.1, nenit 4, paragrafi 4, nenit 14, paragrafi 1.8, i Rregullores për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve me Nr.1427 të datës 28.04.2017, Kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

1. **MIRATOHET** kërkesa e [REDACTED] Komuna e Rahovecit me Nr. Prot. 1494, të dt.29.4.2024 për ndihmë financiare prej 600.00€ (gjashtëqind euro) për mbulimin e shpenzimeve të [REDACTED] e cila studion në SHBA, "Franklin & Marshall College".
2. Mjetet sigurohen nga kodi i subvencioneve të Zyrës së Kryetarit.
3. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Buxhet dhe Financa.
4. Vendimi hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

Arsyetim

[REDACTED] nga Radostë, ka parashtruar kërkesën me datë: 29.4.2024, me numër protokolli 1494, për mbulimin e shpenzimeve për [REDACTED] e cila gjendet me studime në SHBA, Franklin & Marshall College".

Andaj, duke marrë parasysh atë që u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Me vendim të njoftohen:

- [REDACTED]
- Drejtoria për Buxhet dhe Financa, dhe
- Arkivi.





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit



Opština Orahovac/Municipality Rahovec

Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)

Nr./Br./No 4195 Nr. i faq./Br.str./No.pg 123

Data/Datum/Date 10 / 5 / 24

RAHOVEC / ORAHOVAC

Në bazë të nenit 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040, nenit 59 të Ligjit Nr.04/L-042 të Prokurimit Publik, nenit 37 të Ligjit Nr.05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Prokurimin Publik, nenit 69 dhe 92 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 të datës 29.03.2017, Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M

Për caktimin e komisionit për vlerësimin e ofertave

- Caktohet** komisioni për vlerësimin e ofertave për projektin: “Ndërtimi i kanalit të kullimit të tokave bujqësore Fortesë-Celinë”, me Nr. prokurimi: 623-24-3695-5-2-1 dhe Nr. të brendshëm 623-24-036-5-2-1 të datës: 8.5.2024, në këtë përbërje:
 - 1.1. Jetmir Ukaj, kryesues
 - 1.2. Kosovare Gashi, anëtare
 - 1.3. Egzon Thaqi, anëtar
- Komisioni ka për detyrë të bëjë vlerësimin e ofertave për projektin “Ndërtimi i kanalit të kullimit të tokave bujqësore Fortesë-Celinë”, me Nr. prokurimi: 623-24-3695-5-2-1 dhe Nr. të brendshëm 623-24-036-5-2-1 të datës: 8.5.2024.
- Obligohet komisioni që këto punë ti kryej duke u bazuar në legjislacionin në fuqi.
- Komisioni do të fillojë punën menjëherë pas nënshkrimit të këtij vendimi dhe punët duhet të përfundojnë në afat jo më shumë se 30 ditë nga hapja e ofertave.
- Vendimi hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

Vendimi u dërgohet:

- Anëtarëve të komisionit,
- Zyrës së Prokurimit, dhe
- Arkivit.






Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit



Opština Orahovac/Municipality Rahovec

Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



Në mbështetje të dispozitave të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Kosovës (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008”), dispozitave të Ligjit 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 18/2011”), dispozitave të Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik të datës 20.10.2022, nenit 74 dhe 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 i datës 29.03.2017, Kontratës me titull “Ndërtimi i parqeve në Komunën e Rahovecit” me Nr. të Prokurimit 623-21-4279-5-2-1, Kërkesës së Menaxherit të kontratës dhe mbikëqyrësit të drejtëpërdrejtë me Nr. Prot. 1512 të datës 30.4.2024, Kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

Për ndërrimin (kolaodimin) e pozicioneve në kontratën me titull “Ndërtimi i parqeve në Komunën e Rahovecit”

1. Me këtë vendim **lejohet** ndërrimi (kolaodimi) i pozicioneve të situacionit nga një pozicion në tjetrin, në kontratën me titull “Ndërtimi i parqeve në Komunën e Rahovecit” me Nr. të Prokurimit 623-21-4279-5-2-1.
2. Ndërrimi (kolaodimi) i pozicioneve sipas pikës 1 të këtij vendimi do të bëhet nga pozicionet e kontratës: TABELA A: 3 - 3.3, 3.4 dhe 3.7; Nr.4-Pozicioni 4.2; Nr.5.– Pozicioni 5.4; Tabela B – Pozicioni 7, 8, 12, 13; Nr.4 – Pozicioni 4.2; Nr.5-Pozicioni 5.2 dhe 5.5; Nr.6-Pozicionet 6.1 dhe 6.3; Nr.7- pozicioni 7.2; Nr.8 pozicionet 8.7, 8.8, 8.9, 8.10, 8.11, 8.12, 8.13, 8.14 dhe 8.15; Nr.9-pozicioni 9.14, në pozicionet e domosdoshme për realizim: TABELA A:1 – Pozicioni 1.1; Nr.2-pozicioni 2.1, 2.2; Nr.3-Pozicioni 3.1 dhe 3.2; Nr.5-Pozicioni 5.1 dhe 5.3; Nr.4-pozicioni 4.1, 4.2, 4.3, 4.5; Nr.7-Pozicioni 7.1, 7.3; Nr.9-pozicioni 9.7, 9.8, 9.9, 9.13, 9.15; Nr.6-pozicioni 6.21, pa implikime financiare shtesë.
3. Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Zyra e Prokurimit, Menaxheri i Kontratës dhe Mbikëqyrësi i Drejtëpërdrejtë.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

Arsyetim

Ofruesi i shërbimeve (punëkryesi) i kontratës me titull “Ndërtimi i parqeve në Komunën e Rahovecit” me Nr. të Prokurimit 623-21-4279-5-2-1, i ka rekomanduar menaxherit të kontratës ndërrimin (kolaodimin) e pozicioneve në këtë kontratë, me qëllim të përfundimit të këtij projekti.

Pas kësaj, Menaxheri i Kontratës, përmes Mbikëqyrësit të drejtëpërdrejtë ka parashtruar kërkesën me Nr. Prot. 1512 të datës 30.4.2024, me anë të së cilës ka kërkuar nga Zyrtari Kryesor Administrativ ndërrimin (kolaodimin) e pozicioneve nga një pozicion në tjetrin, në kontratën me titull “Ndërtimi i parqeve në Komunën e Rahovecit” me Nr. të Prokurimit 623-21-4279-5-2-1, dhe atë nga pozicionet e kontratës:

TABELA A: 3 - 3.3, 3.4 dhe 3.7; Nr.4-Pozicioni 4.2; Nr.5.– Pozicioni 5.4; Tabela B – Pozicioni 7, 8, 12, 13; Nr.4 – Pozicioni 4.2; Nr.5-Pozicioni 5.2 dhe 5.5; Nr.6-Pozicionet 6.1 dhe 6.3; Nr.7- pozicioni 7.2; Nr.8 pozicionet 8.7, 8.8, 8.9, 8.10, 8.11, 8.12, 8.13, 8.14 dhe 8.15; Nr.9-pozicioni 9.14, në pozicionet e domosdoshme për realizim: TABELA A:1 – Pozicioni 1.1; Nr.2-pozicioni 2.1, 2.2; Nr.3-Pozicioni 3.1 dhe 3.2; Nr.5-Pozicioni 5.1 dhe 5.3; Nr.4-pozicioni 4.1, 4.2, 4.3, 4.5; Nr.7-Pozicioni 7.1, 7.3; Nr.9-pozicioni 9.7, 9.8, 9.9, 9.13, 9.15; Nr.6-pozicioni 6.21, pa implikime financiare shtesë.

Ky ndërrim (kolaodim) i pozicioneve është bërë me qëllim të përfundimit të projektit, me të cilin është rënë dakord me Operatorin Ekonomik dhe me Menaxherin e Kontratës dhe Mbikëqyrësin e Drejtëpërdrejtë të Menaxherit të Kontratës që të bëhet pa implikime financiare.

Pas konsultimit me Sektorin e Prokurimit, Menaxherin e kontratës dhe Mbikëqyrësin e drejtëpërdrejtë, si dhe pas vlerësimit të fakteve në shkresat e lëndës, është vendosur për ndërrim të pozicioneve në kontratën e lartpërmendur.

Andaj, duke u bazuar në atë që u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.


Vendimi u dërgohet:

- ***Menaxheri i Kontratës,***
- ***Mbikëqyrësit të Drejtëpërdrejtë,***
- ***Drejtorisë për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit,***
- ***Zyrës së Prokurimit, dhe***
- ***Arkivit.***





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac/Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



Në mbështetje të dispozitave të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Kosovës (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008”), dispozitave të Ligjit 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 18/2011”), dispozitave të Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik të datës 20.10.2022, nenit 74 dhe 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 i datës 29.03.2017, Kontratës me titull “Ndërtimi i parqeve në Opterushë, Retijë e Poshtme, Dejnë dhe Kolektorit për ujëra të zeza në Ratkoc dhe Rahovec” me Nr. të Prokurimit 623-23-7507-5-2-1 dhe Kërkesës së menaxherit të kontratës të datës 11.3.2024, Kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

Për ndërrimin (kolaodimin) e pozicioneve në kontratën me titull “Ndërtimi i parqeve në Opterushë, Retijë e Poshtme, Dejnë dhe Kolektorit për ujëra të zeza në Ratkoc dhe Rahovec” me Nr. të Prokurimit 623-23-7507-5-2-1

1. Me këtë vendim **lejohet** ndërrimi (kolaodimi) i pozicioneve të situacionit nga një pozicion në tjetrin, në kontratën me titull “Ndërtimi i parqeve në Opterushë, Retijë e Poshtme, Dejnë dhe Kolektorit për ujëra të zeza në Ratkoc dhe Rahovec” me Nr. të Prokurimit 623-23-7507-5-2-1.
2. Ndërrimi i pozicioneve sipas pikës 1 të këtij vendimi do të bëhet nga pozicionet e kontratës: Punët e gjelbërimit – poz 5.3; Punët e betonit – poz 4,4, 4.5, 4.6 dhe 4.7 dhe punët tjera-poz 5.2, në pozicionet e domosdoshme për realizim: TABELA IV-A-A.1; Punët tokësore-Pozicioni 2, 2.1, 2.1.1, 2.1.2, 2.3, 2.6, 2.8; B, B.1, punët përgatitore –pozicioni 1, 1.4; punët tokësore-pozicioni 2, 2.1, 2.1.1, 2.3, 2.4, 2.5, 2.6, 2.7 dhe 2.9, pa implikime shtesë financiare.
3. Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Zyra e Prokurimit, Menaxheri i kontratës dhe Mbikëqyrësi i Drejtëpërdrejtë.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

Arsyetim

Ofruesi i shërbimeve (punëkryesi) i kontratës me titull “Ndërtimi i parqeve në Opterushë, Retijë e Poshtme, Dejnë dhe Kolektorit për ujëra të zeza në Ratkoc dhe Rahovec” me Nr. të Prokurimit 623-23-7507-5-2-1, i ka rekomanduar menaxherit të kontratës ndërrimin (kolaodimin) e pozicioneve në këtë kontratë, me qëllim të përfundimit të këtij projekti.

Pas kësaj, Menaxheri i Kontratës, përmes Mbikëqyrësit të drejtëpërdrejtë ka parashtruar kërkesën me Nr. të datës 11.3.2024, me anë të së cilës ka kërkuar nga Zyrtari Kryesor Administrativ ndërrimin (kolaodimin) e pozicioneve nga një pozicion në tjetrin, në kontratën me titull “Ndërtimi i parqeve në Opterushë, Retijë e Poshtme, Dejnë dhe Kolektorit për ujëra të zeza në Ratkoc dhe Rahovec” me Nr. të Prokurimit 623-23-7507-5-2-1 dhe atë nga pozicionet e kontratës: Punët e gjelbërimit – poz 5.3; Punët e betonit – poz 4,4, 4.5, 4.6 dhe 4.7 dhe punët tjera-poz- 5.2, në pozicionet e domosdoshme për

realizim: TABELA IV-A-A.1; Punët tokësore-Pozicioni 2, 2.1, 2.1.1, 2.1.2, 2.3, 2.6, 2.8; B, B.1, 1. punët përgatitore –pozicioni 1.4; punët tokësore-pozicioni 2, 2.1, 2.1.1, 2.3, 2.4, 2.5, 2.6, 2.7 dhe 2.9.

Ky ndërrim (kolaodim) i pozicioneve është bërë me qëllim të përfundimit të projektit, me të cilin është rënë dakord me Operatorin Ekonomik dhe me Menaxherin e Kontratës dhe Mbikëqyrësin e Drejtëpërdrejtë të Menaxherit të Kontratës që të bëhet pa implikime financiare.

Pas konsultimit me Sektorin e Prokurimit, Ekipin për menaxhimin e kontratës dhe Mbikëqyrësin e drejtëpërdrejtë, si dhe pas vlerësimit të fakteve në shkresat e lëndës, është vendosur për ndërrim të pozicioneve në kontratën e lartpërmendur.

Andaj, duke u bazuar në atë që u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi u dërgohet:

- *Menaxherit të kontratës,*
- *Mbikëqyrësit të Drejtëpërdrejtë,*
- *Drejtorisë për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit,*
- *Njësisë së Prokurimit, dhe*
- *Arkivit.*

Smajl Latifi
Kryetar i Komunës





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo

Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac/Municipality Rahovec

Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA RAHOVEC/OPŠTINA ORAHOVAC/MUNICIPALITY RAHOVEC



Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)

Nr./Br./No 4198 Nr. i faq/Br.str/No.pg 123

Data/Datum/Date 10 / 5 / 24

RAHOVEC / ORAHOVAC

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Republikës së Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 21 dhe 26 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, nenit 11 paragrafi 2 të Ligjit Nr. 06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike, nenit 74 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 i datës 29.03.2017, Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M

Për qasje në dokumente publike

1. **Miratohet** e bazuar kërkesa me Nr. Prot. 02/4193/24, e datës 10.5.2024 për qasje në dokumente publike nga Rrjeti i Organizatave Joqeveritare AVONET dhe i ofrohet qasje e **plotë** në dokumente publike, dhe atë:

1.1.A është nënshkruar kontratë me ndonjë operator ekonomik si rezultat i zhvillimit të aktivitetit të prokurimit numër 623-24-1213-2-2-1, me titull "Sigurimi fizik i objekteve të komunës".

1.2. Kontrata e nënshkruar me operatorin ekonomik fitues, në aktivitetin e prokurimit numër 623-24-1213-2-2-1, me titull "Sigurimi fizik i objekteve të komunës".

2. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

A r s y e t i m

Në mbështetje të nenit 10 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike (QDP), Komuna e Rahovecit ka pranuar kërkesën me Nr. Prot. 02/4193/24, e datës 10.5.2024 për qasje në dokumente publike nga Rrjeti i Organizatave Joqeveritare AVONET, për qasje në dokumente publike.

Pas shqyrtimit të kërkesës, të njëjtit i ofrohet qasje e **plotë** në dokumente publike dhe atë në: A është nënshkruar kontratë me ndonjë operator ekonomik si rezultat i zhvillimit të aktivitetit të prokurimit numër 623-24-1213-2-2-1, me titull "Sigurimi fizik i objekteve të komunës".

Kontrata e nënshkruar me operatorin ekonomik fitues, në aktivitetin e prokurimit numër 623-24-1213-2-2-1, me titull "Sigurimi fizik i objekteve të komunës".

Kërkesa për Qasje në Dokumente Publike është pranuar në mënyrë elektronike.

Komuna e Rahovecit, pas shqyrtimit të kërkesës, si dhe pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi, pala e pakënaqur mund të paraqes ankesë në Agjencionin për Informim dhe Privatësi brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga data e pranimin të tij.

Vendimi u dërgohet:

- **Znj. Blerta Gashi, Zyrtare për shqyrtimin fillestar të QDP,**
- **Rrjeti i Organizatave Joqeveritare AVONET, dhe**
- **Arkivit.**





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo

Komuna Rahovec

Opština Orahovec / Municipality Orahovec

Kryetari i Komunës – President of Municipality / Mayor



REPUBLIKA E KOSOVES / REPUBLIKA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVO
OPŠTINA ORAHOVEC / MUNICIPALITY ORAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS / KABINET PREDSEDIKA OPŠTINE / MUNICIPAL MAYOR CABINET

Njësia Nr./Br./No 02 (Kabineti i Kryetarit të Komunës)

Nr./Br./No 4201 Nr. i faq./Br.str./No.pg 124

Data/Datum/Date 13 / 5 / 2024

RAHOVEC / ORAHOVAC

Në bazë të nenit 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale të Kosovës nr.03/L-040, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28/2008), nenit 40 të Ligjit Nr. 08L-197 për Zyrat Publike, nenit 20 të Rregullores (QRK) Nr.15/2023 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil, të Republikës së Kosovës, si dhe nenit 92 të Statutit të Komunës, kryetari i Komunës Rahovec, merr këtë:

V E N D I M

- Formohet Komisioni i Rekrutimit për të zhvilluar procedurën e pranimin në punë të një Zytari të pranimin, në Drejtorinë për Administratë, sipas konkursit: RN00013686, në këtë përbërje:
 - Skender Hamza, kryesues,
 - Flutura Beqiri, zëvendësues,
 - Isak Hoti, anëtar,
 - Mirsad Shala, zëvendësues,
 - Asllan Mazreku, anëtar,
 - Vjollca Berisha, zëvendësues,
 - Agron Thaqi, anëtar,
 - Antigona Krasniqi, zëvendësues,
 - Valmir Gashi, anëtar,
 - Esat Hoti, zëvendësues.
- Detyrat e komisionit janë të përcaktuara me Ligjin Nr. 08L-197 për Zyrat Publike dhe Rregulloren (QRK) Nr.15/2023 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.
- Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset komisioni.
- Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Me vendim të njoftohen:

- Komisioni,
- Udhëheqësi i Personelit, dhe
- Arkivi.

Smajl Latifi
Kryetar i Komunës






Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit



Opština Orahovac/Municipality Rahovec

Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



Në bazë të nenit 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040, nenit 59 të Ligjit Nr.04/L-042 të Prokurimit Publik, nenit 37 të Ligjit Nr.05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Prokurimin Publik, nenit 69 dhe 92 të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr.1005, të datës 29.3.2017, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

Për caktimin e komisionit për vlerësimin e ofertave

- 1. Caktohet** komisioni për vlerësimin e ofertave për projektin “Riparime në nëntë (9) shkolla fillore dhe të mesme të larta”, me Nr. prokurimi: 623-24-3635-5-2-1 dhe Nr. të brendshëm: 623-24-037-5-2-1, të datës 10.5.2024, në këtë përbërje:
 - 1.1.** Jetmir Ukaj, kryesues,
 - 1.2.** Enise Dina, anëtare,
 - 1.3.** Jeton Krasniqi, anëtare.
- Komisioni ka për detyrë të bëjë vlerësimin e ofertave për projektin “Riparime në nëntë (9) shkolla fillore dhe të mesme të larta”, me Nr. prokurimi: 623-24-3635-5-2-1 dhe Nr. të brendshëm: 623-24-037-5-2-1, të datës 10.5.2024.
- Obligohet komisioni që këto punë t’i kryejë duke u bazuar në legjislacionin në fuqi.
- Komisioni do të fillojë punën menjëherë pas nënshkrimit të këtij vendimi dhe punët duhet të përfundojnë në afat jo më shumë se 30 ditë nga hapja e ofertave.
- Vendimi hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

Vendimi u dërgohet:

- Anëtarëve të komisionit,
- Zyrës së Prokurimit, dhe
- Arkivit.






Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit

Opština Orahovac/Municipality Rahovec

Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



Në bazë të nenit 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040, nenit 59 të Ligjit Nr.04/L-042 të Prokurimit Publik, nenit 37 të Ligjit Nr.05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Prokurimin Publik, nenit 69 dhe 92 të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr.1005, të datës 29.3.2017, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

Për caktimin e komisionit për vlerësimin e ofertave

- 1. Caktohet** komisioni për vlerësimin e ofertave për projektin “Ndërtimi i shtandeve (tezgave) mobile për mbajtjen e panairove”, me Nr. prokurimi: 623-24-3589-5-2-1 dhe Nr. të brendshëm: 623-24-034-5-2-1, të datës 10.5.2024, në këtë përbërje:
 - 1.1.** Jetmir Ukaj, kryesues,
 - 1.2.** Vjollca Berisha, anëtare,
 - 1.3.** Faik Thaqi, anëtar.
- Komisioni ka për detyrë të bëjë vlerësimin e ofertave për projektin “Ndërtimi i shtandeve (tezgave) mobile për mbajtjen e panairove”, me Nr. prokurimi: 623-24-3589-5-2-1 dhe Nr. të brendshëm: 623-24-034-5-2-1, të datës 10.5.2024.
- Obligohet komisioni që këto punë t'i kryejë duke u bazuar në legjislacionin në fuqi.
- Komisioni do të fillojë punën menjëherë pas nënshkrimit të këtij vendimi dhe punët duhet të përfundojnë në afat jo më shumë se 30 ditë nga hapja e ofertave.
- Vendimi hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

Vendimi u dërgohet:

- Anëtarëve të komisionit,
- Zyrës së Prokurimit, dhe
- Arkivit.





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac / Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



	REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVO KOMUNA RAHOVEC / OPŠTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY RAHOVEC	
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS / KABINET PREDSEDIKA OPŠTINE / MUNICIPAL MAYOR CABINET		
Njësia Nr./Br./No 02 (Kabineti i Kryetarit të Komunës)		
Nr./Br./No 4205 Nr. i faq./Br.str./No.pg 124		
Data/Datum/Date 13 / 5 / 24		
RAHOVEC / ORAHOVAC		

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040, (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), nenit 59 të Ligjit Nr.04/L-042 të Prokurimit Publik, nenit 37, i Ligjit Nr.05/L-068, për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit për Prokurimin Publik, nenit 63 dhe 92 të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr.1005, i datës 29.3.2017, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

- Formohet komisioni për vlerësimin e ofertave në projektin **“Asgjësimi i mbetjeve medicinale dhe i barnave pa afat – ritenderim”**, me Nr. Prokurimi: **623-24-2530-2-2-1** dhe Numër të brendshëm: **623-24-016-2-2-1**, të datës **11.4.2024**, në përbërje prej:
 - 1.1. Egzon Thaqi, kryesues,
 - 1.2. Kosovare Gashi, anëtare,
 - 1.3. Enise Dina, anëtare.
- Komisioni ka për detyrë që të bëjë vlerësimin dhe krahasimin e ofertave të tenderit për projektin **“Asgjësimi i mbetjeve medicinale dhe i barnave pa afat – ritenderim”**.
- Obligohet komisioni që këto punë t'i kryejë duke u bazuar në legjislacionin aktual në fuqi.
- Komisioni do të fillojë punën menjëherë pas nënshkrimit të këtij vendimi dhe punët duhet të përfundojnë në një afat të arsyeshëm.
- Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi shfuqizohet **vendimi me Nr. 4083, të datës 12.4.2024**.
- Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

U dërgohet:

- Anëtarëve të komisionit,**
- Zyrës së Prokurimit, dhe**
- Arkivit.**

Smajl Latifi
Kryetar i Komunës



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo

Komuna Rahovec

Opština Orahovac/Municipality Rahovec

Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



KOMUNA RAHOVEC/OPŠTINA ORAHOVAC/MUNICIPALITY RAHOVEC

KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS/KABINET PRESEDIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET

Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)

Nr./Br./No 4210 Nr. i faq/Br.str/No.pg 124

Data/Datum/Date 14 / 5 / 2024

RAHOVEC / ORAHOVAC

Në bazë të nenit 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale të Kosovës nr.03/L-040, (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28/2008), në nenin 40 të Ligjit Nr. 08L-197 për Zyrtarët Publikë, nenit 20 të Rregullores (QRK) Nr.15/2023 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, si dhe nenit 92 të Statutit të Komunës, kryetari i Komunës Rahovec, merr këtë:

V E N D I M

- Formohet Komisioni i Rekrutimit për të zhvilluar procedurën e pranimin në punë të një Udhëheqësi të Njesisë së Shërbimit të Menaxhimit Financiar, në Drejtorinë për Arsim, sipas konkursit: RN00013741, në këtë përbërje:
 - Asllan Mazrreku, kryesues,
 - Artan Asllani, zëvendësues,
 - Ekrem Bytyqi, anëtar,
 - Esat Hoti, zëvendësues,
 - Kapllan Gashi, anëtar,
 - Shqipe Tara-Sokoli, zëvendësuese,
 - Agron Thaqi, anëtar,
 - Antigona Krasniqi, zëvendësuese,
 - Jeton Krasniqi, anëtar,
 - Admirim Durguti, zëvendësues.
- Detyrat e komisionit janë të përcaktuara me Ligjin Nr. 08L-197 për Zyrtarët Publikë dhe Rregulloren (QRK) Nr.15/2023 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.
- Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset komisioni.
- Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.


Me vendim të njoftohen:

- Komisioni,
- Udhëheqësi i Personelit, dhe
- Arkivi.





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac/Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



Në mbështetje të dispozitave të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 44 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, dispozitave të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës, nenit 72 të Rregullores Nr. 001/2022 për prokurimin publik me Nr. Prot. 82/2022, të datës 20.10.2022, nenit 74 dhe 92, paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr. 1005, i datës 29.3.2017, kërkesës dhe rekomandimit të Menaxherit të Projektit, të datës 14.5.2024, për ndërprerjen e kontratës me titull: "Shërbime konsulente individuale për nevojat e Komunës së Rahovecit", me Nr. Identifikues: 623-22-5173-2-1-1/C378, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

Për ndërprerjen e kontratës me marrëveshje të dyanshme, me titull "Shërbime konsulente individuale për nevojat e Komunës së Rahovecit"

1. **Miratohet** kërkesa e menaxherit të projektit për ndërprerjen e kontratës me marrëveshje të dyanshme, me titull "Shërbime konsulente individuale për nevojat e Komunës së Rahovecit", me Nr. identifikues: 623-22-5173-2-1-1/C378, me Nr. Prot. 2351, e datës 4.7.2022.
2. **Obligohet** Zyra e Prokurimit që të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme konform dispozitave ligjore në fuqi, për ndërprerjen e kontratës, sipas pikës 1 të këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

A r s y e t i m

Z. Faik Thaqi nga Çifllaku, ka parashtruar kërkesë të menaxherit të kontratës me Nr. Prot. 1514, të datës 30.4.2024, për ndërprerjen e kontratës me titull: "Shërbime konsulente individuale për nevojat e Komunës së Rahovecit", me Nr. Identifikues: 623-22-5173-2-1-1/C378 dhe me Nr. Prot. 2351, e datës 4.7.2022, i cili ishte i angazhuar konsulent individual për pranimin e lëndëve dhe regjistrimin e kërkesave për kadastër dhe pronë, nga data 4.7.2022.

Pas kësaj, menaxheri i kontratës, me kërkesën e datës 14.5.2024, ka kërkuar dhe njëherit ka rekomanduar Zyrtarin Kryesor Administrativ, ndërprerjen e kontratës me titull: "Shërbime konsulente individuale për nevojat e Komunës së Rahovecit", me Nr. Identifikues: 623-22-5173-2-1-1/C378, me Nr. Prot. 2351, e datës 4.7.2022, në të cilën z. Faik Thaqi ishte i angazhuar konsulent individual për pranimin e lëndëve dhe regjistrimin e kërkesave për kadastër dhe pronë.

Duke u bazuar në nenin 10 të Kushteve të Përgjithshme të Kontratës me titull "Shërbime konsulente individuale për nevojat e Komunës së Rahovecit", me Nr. Identifikues: 623-22-5173-2-1-1/C378, si dhe dispozitave të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës, janë

përmbushur të gjitha kushtet ligjore për ndërprerjen e kësaj kontrate me kërkesë të Ofruesit të Shërbimeve.

Pas administrimit të të gjitha provave, kryetari i Komunës ka konstatuar se janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore për ndërprerjen e kontratës me Nr. Prot. 2351, e datës 4.7.2022, me titull: “Shërbime konsulente individuale për nevojat e Komunës së Rahovecit” me Nr. identifikues: 623-22-5173-2-1-1/C378.

Nga se u tha më lart, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Me vendim të njoftohen:

- *Z. Faik Thaqi,*
- *Zyra e Prokurimit,*
- *Menaxheri i projektit,*
- *Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i menaxherit të projektit, dhe*
- *Arkivi.*





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo



Komuna Rahovec
Opština Orahovac / Municipality Rahovec

Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Mayor Office

	REPUBLIKA E KOSOVES / REPUBLIKA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVO KOMUNA RAHOVEC / OPŠTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY RAHOVEC	
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS / KABINET PREDSEDIKA OPŠTINE / MUNICIPAL MAYOR CABINET		
Njësia Nr./Br./No 02 (Kabineti i Kryetarit të Komunës)		
Nr./Br./No 4212 Nr. i faq./Br.str./No.pg 125		
Data/Datum/Date 15 / 5 / 24		
RAHOVEC / ORAHOVAC		

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës Nr. 03/L040, (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, 28/2008), nenit 74 dhe nenit 92, paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës, Nr. 1005, i datës 29.3.2017, nenin 21, paragrafi 2, pika 3 të Rregullores për kushtet, kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve me Nr. prot. 1427, të datës 28.4.2017, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

1. Miratohet Kërkesa e [REDACTED] Komuna e Rahovecit, me nr. prot. 1631, të datës 14.5.2024.
2. [REDACTED] i ndahen mjetet materiale në shumën prej 500 euro (pesëqind euro) për mbulimin e shpenzimeve të mjekimit – ndërhyrjes kirurgjikale, të cilën duhet ta kryejë sa ma shpejt, sepse është diagnostikuar me tumor.
3. Mjetet do të sigurohen nga kodi i subvencioneve të Drejtorisë për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale.
4. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Buxhet dhe Financa.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

U dërgohet:

- [REDACTED]
- Drejtorisë për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale,
- Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, dhe
- Arkivit.





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac/Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 81 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-92, nenit 70, paragrafi 70.18, i Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik të datës 20.10.2022, nenit 74 dhe nenit 92, paragrafi 1 dhe 4, të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr.1005, i datës 29.3.2017 dhe propozimit të Përgjegjësit të Njesisë Kërkuese dhe Zyrtarit Përgjegjës të Prokurimit, kryetari i Komunës së Rahovecit, merr këtë:

V E N D I M

